



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

DATË/A:	30/10/2020
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Komitetin Olimpik të Kosovës (KOK) Federatat sportive të Kosovës (FSK) Anëtarët e FK (Klubet)
CC:	Znj.Vlora Dumoshi, Ministre/MKRS z.Fitim ARIFI U.D. Drejtor i Departamentit të Sportit/MKRS
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z.Ibër ALAJ-Zv. Sekretar i Përgjithshëm/MKRS
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkore-Udhëzime lidhur me përmbushjen e obligimeve ligjore që rregullojnë çështjet e mbajtjes së kuvendeve të punës dhe kuvendeve zgjedhore për Komitetin Olimpik të Kosovës, federatat sportive të licencuara dhe anëtarët e tyre

Të nderuar,

Udhëzime lidhur me përmbushjen e obligimeve ligjore që rregullojnë çështjet e mbajtjes së kuvendeve të punës dhe kuvendeve zgjedhore për Komitetin Olimpik të Kosovës, federatat sportive të licencuara dhe anëtarët e tyre.

Së pari, urojmë të jeni mirë me shëndet në sfidat e rënda të shkaktuara nga pandemia COVID -19.

Në vijim, duam të ju informojmë dhe të udhëzojmë mbi disa obligime për të gjitha organizatat sportive (KOK, FSK dhe Klubet) që duhet t'i përmbahen legjislacionit në fuqi përgjatë funksionimit të tyre të përgjithshëm me theks të veçantë në çështjet që ndërlidhen me rregullat për organizimin e kuvendeve të punës dhe atyre zgjedhore.

Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2003/24 për Sporti dhe dispozitat e pandryshuara/në fuqi të Ligjit Nr.2003/24 për Sport, të cilat dispozita janë të harmonizuara me rregullat e organizatave sportive ndërkombëtare përkatësisht dispozita që merren me rregullimin dhe promovimin e interesit publik në fushën e sportit, pa cenuar pavarësinë e garantuar me normat e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe apo organizatave tjera sportive ndërkombëtare për federatat dhe klubet e licencuara në Republikën e Kosovës (shih nenin 27 të Ligjit Nr. 2003/24 për Sportin).

Kuvendet e punës për vitin kalendarik dhe fiskal 2019, është dashur të mbahen gjatë muajit Janar, Shkurt dhe Mars të vitit 2020. Rreth 2/3 e FSK kanë arritur ta respektojnë këtë kërkesë. Mirëpo për shkak të përhapjes së pandemisë COVID-19 dhe mbylljes së plotë të aktiviteteve sportive, rreth 1/3 e FSK duke përfshirë edhe KOK nuk i kanë mbajtur Kuvendet e tyre të punës (shih nenin 20 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2015 për Funksimin e Komitetit Olimpik të Kosovës dhe nenin 11 (paragrafi 3) të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 për Themelimin dhe Licencimin e Federatave dhe Shoqërive Sportive).

Prandaj, organizatat sportive që nuk i kanë mbajtur kuvendet e rregullta të punës për vitin 2019, udhëzohen që ato t'i mbajnë më së largu deri në fund vitit 2020 duke respektuar udhëzimet nga IKSHPK dhe protokollet zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë duke shqyrtuar mundësitë teknike që një gjë e tillë të realizohet edhe në formë të organizimit të këtyre kuvendeve të rregullta të punës, në formën online.

Ministria përkatëse për sport, rikujton përmes kësaj qarkoreje se mbajtja e kuvendeve vjetore të punës, është e natyrës detyruese në bazë të akteve normative në fuqi.

Ministria përkatëse për sport, udhëzon se legjislacioni në fuqi që rregullon veprimtarinë sportive, e që është i harmonizuar edhe me aktet konstituive të KOK dhe federatave sportive si dhe me aktet normative të organizatave sportive ndërkombëtare, në rastet e organizimit të kuvendeve të punës dhe ato zgjedhore të organizatave a federatave sportive paraprakisht obligon domosdoshmërinë që të njëjtat të mbahen nëpër klube dhe të dërgohen raportet në Federatën përkatëse (sipas udhëzimeve administrative në fuqi), më së largu deri më 31 Janar 2021.

Pas përfundimit të Kuvendeve (te rregullta e zgjedhore te klubeve, nen monitorimin e Federatave sportive përkatëse dhe komunave përkatëse, gjate muajit Shkurt e me se voni deri me 28 Shkurt mbahen Kuvendet e rregullta dhe ato zgjedhore nen monitorimin e MKRS dhe KOK!

Pas përfundimit të kuvendeve te rregullta dhe zgjedhore te Federatave, gjate muajit Mars e me se voni deri me 31 Mars, mbahen Kuvendet e rregullta dhe zgjedhore te KOK nen monitorimin e MKRS.

Ministria udhëzon palët e adresuara në këtë adresim se udhëzimet administrative respektive për zbatimin e Ligjit në fuqi për sport, përkatësisht udhëzimet që përcaktojnë rregullat dhe kriteret e përgjithshme për organizimin, funksionimin dhe licencimin e Komitetit Olimpik të Kosovës dhe federatave e klubeve sportive, bëjnë një dallim thelbësor të përmbajtjes, kriterëve dhe detyrave që kanë në mes vete kuvendet e punës nga ato zgjedhore.

Në këtë drejtim, Ministria në bazë të mandatit të saj, udhëzon që të respektohen rigorozisht dispozitat e akteve normative në fuqi dhe të lexohen e zbatohen drejt këto norma të detyrueshme sipas qëllimit dhe funksionit rregullativ të fushës që e kanë. Kuvendet e punës kanë natyrë, qëllim e funksion të ndryshëm, rrjedhimisht edhe procedura të veçanta të konvokimit të tyre nga kuvendet zgjedhore. Në secilin rast, Ministria, konsideron të domosdoshme që edhe në rastin e kuvendeve të punës edhe në ato zgjedhore, këto zhvillime të ndodhin duke u bazuar në dispozitat në fuqi të Ligjit për Sport, akteve nënligjore dhe statuteve të vet organizatave sportive si parakusht për licencim nga MKRS për Ciklin Olimpik 2021-2024

Qarkorja e MKRS, mbështetet në:

- Ligjit Nr. 2003/24 për Sport
- Ligjin Nr. 04/L - 075 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/24 për Sport
- Akteve nënligjore; ➤ Udhëzimi administrativ për Licencimin e Federatave Sportive
- Ne vendimin e Asamblesë së fundit të KOK-ut kur është arritur marrëveshja që muaji Janari të jetë periudha kohore kur Klubet i mbajnë Kuvendet, muaji Shkurt të jetë muaji kur Federatat i mbajnë Kuvendet dhe përfundimisht Marsi të jetë muaji kur KOK e mbanë Asamblenë.

Në zbatim përshtatshmërisht të praktikave të vendosura nga Bordi Ekzekutiv i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, përkatësisht vendimet për shtyrjen e Lojërave Olimpikë Verore Tokio 2020 për një vit dhe lejimi i mundësive që komitetet olimpikë kombëtare të vendosin nëse duan të shtyejnë apo jo asamblenë të tyre më së voni në Tetor të vitit 2021, KOK një gjë të tillë duhet ta vendosë në Asamblenë e Punës për vitin 2019 që duhet të mbahet deri në fund të vitit 2020, përkatësisht pasi t'i kenë përfunduar federatat kuvendet e punës.

Ministria është e gatshme të mbështesë veprimtarinë e organizatave sportive brenda fushës së përgjegjësisë së saj administrative, sa herë që një gjë e tillë kërkohet.

Me respekt